L I G J
Nr.8974, datë 21.11.2002

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.8691, DATË 16.11.2000 "PËR PRODHIMIN DHE TREGTIMIN E DUHANIT DHE TË CIGAREVE"

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr.8691, datë 16.11.2000 "Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve" bëhen shtesat si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 19 shtohet neni 19/a si më poshtë:

"Produktet e duhanit që tregtohen në Shqipëri duhet të përmbajnë në ambalazh, respektivisht etiketën e tyre, të dhëna për përmbajtjen e katranit dhe nikotinës. Këto të dhëna duhet të maten në bazë të standardeve ndërkombëtare në fuqi.

Të dhënat për katranin dhe nikotinën në paketat e cigareve duhet të shtypen në një faqe anësore të paketës, në gjuhën shqipe, me shkrim të lexueshëm qartë dhe në kontrast me sfondin, në një sipërfaqe që zë jo më pak se 10 për qind të sipërfaqes respektive të faqes anësore të paketës."

Neni 2

Pas nenit 19/a shtohet neni 19/b si më poshtë:

"Në çdo pako duhani duhet të shkruhet në gjuhën shqipe, në pjesën më të dukshme të tij, paralajmërimi i përgjithshëm "Duhani dëmton rëndë shëndetin".

Në paketat e cigareve paralajmërimi i përgjithshëm në gjuhën shqipe "Duhani dëmton rëndë shëndetin" duhet të shkruhet në faqen e madhe ballore të paketës, ndërsa në faqen tjetër ballore duhet të shkruhet në gjuhën shqipe njëri nga paralajmërimet alternative:

- "Pirja e duhanit shkakton kancer"
- "Pirja e duhanit shkakton sëmundje të zemrës"
- "Pirja e duhanit shkakton sëmundje vdekjeprurëse"
- "Pirja e duhanit shkakton kancer, bronkit kronik dhe sëmundje të tjera të kraharorit"
- "Pirja e duhanit dëmton shëndetin e njerëzve që ju rrethojnë"
- "Mbroni fëmijët nga duhani"
- "Pirja e duhanit nga gratë shtatzëna dëmton fëmijën".

Paralajmërimet alternative duhet të shtypen në paketa në mënyrë të tillë që të garantohet shpërndarja e barabartë e tyre në produktet e prodhuara, me një tolerancë prej rreth pesë për qind.

Paralajmërimet e përmendura në paragrafin e dytë të këtij neni duhet të zënë jo më pak se 10 për qind të sipërfaqes së secilës nga faqet ballore të paketës. Paralajmërimet duhet të shkruhen me shkrim të qartë dhe të lexueshëm, me shkronja të trasha dhe në kontrast me sfondin, nuk duhet të shtypen në pjesë që mund të dëmtohen nga hapja e paketës, si dhe nuk duhet të shtypen në mbështjellësen transparente ose në ndonjë mbështjellëse tjetër të jashtme.

Për produktet e tjera të duhanit, paralajmërimi i përgjithshëm i përmendur në paragrafin e parë duhet të shtypet në ambalazh ose të ngjitet mbi të, duke u vendosur në pjesët më të dukshme të tij, në kontrast me sfondin dhe në mënyrë që të jetë i dukshëm dhe i lexueshëm qartazi. Në çdo rast, nuk duhet të bëhet e mundur fshehja, mbulimi ose ndërprerja e tij nga pamja ose shkrime të tjera."

Neni 3

Pas nenit 19/b shtohet neni 19/c si më poshtë:

“Duke filluar nga data 31 mars 2003, për importuesit dhe për prodhuesit vendas ndalohet tregtimi i produkteve të duhanit që nuk plotësojnë kushtet lidhur me etiketimin, të përmendura në nenet 19/a dhe 19/b të këtij ligji, në territorin e Republikës së Shqipërisë.”

Neni 4

Në nenin 22, në rreshtin e parë të shkronjës “c”, pas fjalëve “me kërkesat e nenit 19” shtohen fjalët: “shkronjat “a”, “b”, “c”,”.

Neni 5

Në nenin 22, pas shkronjës “c” shtohet paragrafi c/1 si më poshtë:

“Tregtimi i produkteve të duhanit në kundërshtim me kërkesat e neneve 19/a, 19/b dhe 19/c të këtij ligji në territorin e Republikës së Shqipërisë dënohet me konfiskimin dhe shkatërrimin e produkteve të duhanit dhe me heqjen e lejes përkatëse.”

Neni 6

Pas pikës 1 të nenit 23 shtohet pika 2 si më poshtë:

“Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe ajo e Doganave janë përgjegjëse për konfiskimin dhe shkatërrimin e produkteve, paketimi i të cilave nuk është në përputhje me kërkesat e këtij ligji.”

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3603, datë 20.12.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu